



ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Ri-Shqyrtim të dt.29.06.2021 nga Operatorit Ekonomik, “**Toifor**”Shpk & “**Lulishtja Labi-A**”Shpk lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Mirëmbajtja e hapësirave publike (parqeve dhe shesheve)**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-1781-2-1-1, nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Refuzohet** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatorëve Ekonomik “**Toifor**”Shpk & “**Lulishtja Labi-A**”Shpk lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Mirëmbajtja e hapësirave publike (parqeve dhe shesheve)**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-1781-2-1-1, Kundër Njoftimit të Vendimit të Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 24.06.2021 të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.
2. Vërtetohet Njoftimi i Vendimit të Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 24.06.2021, të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës..
3. Autoriteti Kontraktues - Qëndron prapa Njoftimit mbi Vendimin e Aktivitetit të Prokurimit dhe sipas LPP-ës dhe legjislacionit detyësor të Prokurimit Publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetimi

Operatorët Ekonomik, “**Toifor**”Shpk & “**Lulishtja Labi-A**”Shpk, me date 29.06.2021 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Mirëmbajtja e hapësirave publike (parqeve dhe shesheve)**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-1781-2-1-1, Kundër Njoftimit të Vendimit të Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 24.06.2021.

Pas analizimit të pretendimit ankimore AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar për arsye se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë se: Aktiviteti i prokurimit për kriter

ka pasur Tenderin e përgjegjshëm me çmim më të lirë. Andaj ju si OE keni rezultuar me çmim më të lirë por nuk keni qenë i përgjegjshëm sipas kriterëve të kërkesave të kushteve të dosjes së tenderit të **III.2.3)Kapacitetet ekonomike dhe Financiare, III.2.4) Kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale.**

Kriteret në dosjen e tenderit për: "Kërkesat ekonomike dhe financiare" ; "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kanë qenë si në vijim:

<p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p> <p>Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 400,000.00 Euro</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur</p>
<p>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjajshme (mirëmbajtje e parqeve) në vlerë jo më pak se 300,000.00 € në tre vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit të kontratës. Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumë së kërkuar.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve</p>
<p>Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt, min. 5 punëtorë të rregullt në kompani. - Një menaxher të projektit i cili duhet të jetë i diplomuar ose master i ekologjisë me përvojë pune minimumi 3 vite pas diplomimit ose bachelor i diplomuar i Bujqësisë (drejtimi mbrojtja e bimëve) me përvojë pune së paku 3 vite pas diplomimit.</p>	<p>Lista e stafit – e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. ku specifikohen Emrin,Mbiemrin,Profesionin, Eksperienca dhe pozicioni të angazhuar me kontrate apo parakontratë në kompani në afat të projektit. - Për ekologun apo inxhinierin e bujqësisë , diploma universitare, CV-a origjinale e nënshkruar nga inxhinieri, kontrata ose parakontrata e punës me punëdhënësin valide, vendimi mbi caktimin e menaxher projektit, minimumi një referencë nga punëdhënësi që ka menaxhuar projekte të ngjajshme</p>

Përgjigjeje në pretendimet ankimore se:

Jeni diskualifikuar sepse tenderi-oferta juaj është refuzuar për këto arsye:

1. Mungojn referencat të realizuara gjatë tri viteve të fundit për shërbime të ngjashme(mirëmbajtje të parqeve) nga se referencat e ofruara nga kërkesa për sqarime shtesë për realizimin e projektit me “Viva Fresh”, nuk korospodojn me datat dhe vlerën e paraqitur në aneksin 6.
 2. Dokumentet e ofruara për menaxherin e projektit nuk janë në përputhje me dokumentet e kërkuara në DT nga AK, ku ju është kërkuar së paku një reference për menaxhimin e një kontrate të natyrës së ngjashme.
 3. Dokumenti i ofruar për paisjet nuk është në përputhje me dokumentet e kërkuara në DT të inicuar nga AK tek aneksi 7, gjegjësisht autoshporta për krasitje të drunjëve është regjistruar pas hapjes së ofertës, po ashtu nuk është ofruar dëshmi që traktori i ofruar 4x4 dhe mungon dëshmia për posedim të frezës.
- AK kërkoj sqarime shtesë për dokumentet e sipërme me **Leter Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit** (gjëni të bashkangjitur).
 - Dokumentet e dërguara nga OE të cilat nuk I plotësojn kriteret AK-së sipas DT gjinden në **platformen e e-prokurimit te dokumentet tjera.**

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

KOMUNA E PODUJEVËS, RR.ZAHIR PAJAZITI - PODUJEVË

‘Toifor’ & ‘Lulishtja Labi-A’ Prishtinë

Nr. i prokurimit:	615-21-1781-2-1-1
Nr. i brendshëm	61521046211

Titulli: Mirëmbajtja e hapësirave publike (parqeve dhe shesheve)

Ë e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

- 1 *Mungon referencë e menaxherit të kontratës*
- 2 *Mungojnë referenca për shërbime të ngjajshme (mirëmbajtje e parqeve)*
- 3 *Tek lista e pajtjese gjegjesishte tek dëshmia e kërkuar në pikën 5 – traktor 4x4, mungon dëshmia se është traktor 4x4 dhe dëshmia për posedimin e frezës, në pikën 6 autoshporte keni ofruar me regjistrim të skaduar*

Përgjigja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues ose në e-mailin prokurimi.podujeve@rks-gov.net brenda 2 ditëve nga data e kësaj kërkesë.

Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht.

Me respekt,

Ganimete Mahmuti



- Sqarimet shitesë të kërkuara nga komisioni i vlerësimit dhe AK me leter standarde në platformen e e-prokurimit të **dokumentet tjera** të dërguara nga ju nuk i plotësojnë kërkesat e DT.

AK në bazë të kritereve të kushteve të DT, parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim, nuk ka disponuar me dokumentet e kërkuara të cekura më lartë, gjithashtu edhe verifikimet dhe sqarimet shitesë nuk i kan plotësuar për dhënje të kontratës.

Nga se u cek më lartë, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/l-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në institucionet tjera kompetente.

Nr. 14-370/03-0052437/21
Podujevë,
30.06.2021



Menaxheri ZP
Rasim Fejza